

MARENGLLEN VERLI**RRETH TRAJTIMIT TË ÇËSHTJES SHQIPTARE
NË JUGOSLLAVI NË RRAFSHIN BALLKANIK
(pas vitit 1945)****I. Rrënjët e problemit**

Çështja e shqiptarëve në Jugosllavi, përkatësisht çështja e Kosovës, çështja e shqiptarëve në Maqedoni, në Malin e Zi dhe në jugun e Republikës së Serbisë në periudhën pas Luftës së Dytë Botërore, padyshim, është pjesë e çështjes shqiptare në tërësi, prehistoria e afërt e së cilës zuri fill në vitin 1913, me copëtimin e njohur drastik të trojeve shqiptare. Këtu nuk po llogarisim shfaqjen e pjesshme të kësaj çështjeje në vitet e mëparshme, ku do të vlente të përmendej, në dekadën e tetë të shekullit të XIX, pushtimi, aneksimi dhe spastrimi etnik i sanxhakut të Nishit nga gati e gjithë popullsia shqiptare¹.

Nën pushtimin serb dhe malazez shqiptarët e Kosovës e më gjerë, pësuan nga e njëjta politikë e përsëritur në vitet 1913-1915². Jugosllavia e Versajës, gjatë periudhës midis dy luftërave botërore, përkatësisht në vitet 1918-1941, edhe pse kishte pranuar e nënshkruar Traktatin për minoritetet të Lidhjes së Kombeve, anëtare e së cilës ishte, nuk pati ndonjë qëndrim tjetër ndaj shqiptarëve. Madje në këtë periudhë u institucionalizua dhe perfeksionua si kurrë më parë politika e spastrimit etnik përmes dhunës e terrorit, shpronësimit, shpërnguljes masive dhe kolonizimit sllav të viseve shqiptare, e njëherësh edhe e asimilimit të shqiptarëve të krishterë, që nuk ishin të paktë jo vetëm në krahina kompakte si Reka e Dibrës, por edhe në viset e Ohrit, Prespës,

¹ *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. II, Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë: "Toena", 2002, f. 144, 147, 148; Sabit Uka, *Dëbimi i shqiptarëve nga Sanxhaku i Nishit dhe vendosja e tyre në Kosovë*, vëll. III, Prishtinë: 2004, f. 38-40; etj.

² *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. III, Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë: "Toena", 2007, f. 424-428; Marenglen Verli, *Reforma agrare kolonizuese në Kosovë 1918-1941*, Bon/Tiranë: "Iliria", 1992, f. 9-21; etj.

Manastirit³ etj. Në këtë rast të dytë, veprimet e nisura më herët përmes institucioneve fetare, shkollës dhe, së fundi, me anën e diferencimit social e politik të shqiptarëve të krishterë nga shqiptarët e besimit mysliman, u evidentuan si hapa jo pa efekt, rezultati i të cilave do të konsolidohej gjatë dekadave në vijim.

Është për të vënë në dukje se në viset jugore të Shtetit Serbo-Kroato-Slloven, përkatësisht në krahinat (njësi administrative) e Vranjës, Shkupit dhe Manastirit, përndryshe në Banovinën e Vardarit (në vitet 30), përveç shqiptarëve, pësoi keqtrajtim edhe popullsia sllave vendase, veçse në këtë rast politika zyrtare e Beogradit synonte armiqësimin e saj me shqiptarët, ndërprerjen e ndikimit të Bullgarisë dhe serbizimit të tyre. Natyrisht në viset në fjalë jetonin edhe pakica të tjera kombëtare, të vlllehëve, turqve etj., ndaj të cilave gjithashtu pati politikë të diferencuar, të llogaritur në bazë të koniunkturave të brendshme të shtetit dhe atyre ndërkombëtare, veçanërisht të raporteve me shtet fqinj ose të rajonit, si Greqia e Turqia⁴.

Dobësia e shtetit shqiptar të pavarur, në vitet 20-30-të, varësia e tij në një masë të konsiderueshme nga Italia, si edhe politika e të Mëdhënëve, në radhë të parë e Francës dhe për një periudhë të gjatë edhe e Britanisë së Madhe, për të penguar penetrimin italian në Ballkan, përcaktuan dimensionin maksimal të dhunës zyrtare të Beogradit mbi popullsinë shqiptare⁵.

Shifrat e pasojave të politikës së përmendur janë domethënëse. Gjatë dy dekadave rreth 300.000 shqiptarë u shpërngulën nga Jugosllavia, në pjesën më të madhe nga Kosova dhe nga trevat shqiptare lindore⁶. Nga viset qendrore e ato të periferive lindore e jugore të Banovinës së Vardarit popullsia shqiptare u zhduk nëpërmjet shpërnguljes e asimilimit,

³ *Po aty; Shqiptarët e Maqedonisë*, Shkup: Meshihati i BI në RM, 1994, f. 97, 127, 133, 145, 315; Tahir Abdyli, *Hasan Prishtina në lëvizjen kombëtare e demokratike shqiptare 1908-1933*, Prishtinë: "Rilindja", 1990, f. 338.

⁴ Noel Malcolm, *Kosova një histori e shkurtër*, Prishtinë: "Koha", 1998, f. 290-300; Aleksandër Apostolov, *Kolonizacijata na Makedonia vo stara Jugoslavija*, Skopje: "Култура", 1966, f. 151; T. Abdyli, *vep. e për.*, f. 229-231, 244, 248, 361; *Historia e Popullit Maqedonas*, Shkup: "Flaka e vëllazërimit", 1983, f. 202, 209-216, 221-227, 243; etj.

⁵ T. Abdyli, *vep. e për.*, f. 259, 322 etj.; M. Verli, *vep. e për.*, f. 181-183; etj.

⁶ Zamir Shtylla, "Aspekte të politikës së shpërnguljes me dhunë të shqiptarëve nga Kosova në vitet 1936-1941", *Studime historike*, nr. 3, Tiranë: 1990; shih edhe: *Dëbimet e shqiptarëve dhe kolonizimi i Kosovës (1977-1995)*, Prishtinë: "OIK", 1997; etj.

ose u reduktua ndjeshëm. Në vise të tilla si Manastiri, Përlepi, Shkupi, zona e Prespës, etj., raportet etnike të popullsisë u përmbysën në përmasa drastike në dëm të popullsisë shqiptare. Nga ana tjetër u hodh fara e filloi të kultivohej armiqësia midis shqiptarëve e sllavëve të atjeshëm, ndaj të cilëve goditja vinte kryesisht nëse prireshin apo kishin preferenca për Bullgarinë, ose, përndryshe, ishin pjesëmarrës në lëvizjen komite probullgare, e cila ishte mjaft aktive në vitet 20⁷.

Lufta e Dytë Botërore solli situata të reja në rajon e rrjedhimisht edhe në trevat shqiptare jashtë kufijve të Shqipërisë Politike të vitit 1913. Pjesa më e madhe e Kosovës së sotme dhe një pjesë e konsiderueshme e viseve shqiptare lindore, sot të gjendura në pjesën perëndimore e veriperëndimore të Republikës së Maqedonisë, pas vitit 1941 u aneksuan nga Italia dhe u përfshinë në shtetin shqiptar të futur në suazat e Perandorisë Italiane qysh në prill të vitit 1939. Edhe pse nën pushtim, perioda në fjalë u konceptua si çlirim nga pjesa më e madhe e popullsisë shqiptare, e cila siguroi rikthimin e pronave të prekura (të shpronësuar ose sekuestruara) në vitet 1913-1941, administratë e shkolla shqipe, treg të unifikuar, të drejtën e përdorimit të simboleve kombëtare etj⁸.

Është për të vënë në dukje se edhe pse Italia e Bullgaria ishin aleate në Luftën e Dytë Botërore, trajtimi i popullsisë, përkatësisht sllave dhe shqiptare në zonat respektive të pushtimit, kishte diferencë që në zonën bullgare shkonin në dëm të popullsisë shqiptare⁹. Në këtë rast ngjashmëria me periudhën e viteve 1916-1918 të Luftës së Parë Botërore ishte e dukshme. Gjithsesi, aleatët e mëdhenj të bllokut antifashist, SHBA, BRSS dhe Britania e Madhe, duke mos njohur ndryshimin e kufijve të realizuar me dhunë nga vendet e Bllokut Fashist, i dhanë

⁷ *Shqiptarët e Maqedonisë ...*, f. 361, 389, 399; *Historia e Popullit Maqedonas ...*, f. 212-223; N. Malcolm, *vep. e përm.*, f. 275-300; Marenglen Verli, *Kosova - sfida shqiptare në historinë e një shekulli*, Tiranë: "BOTIMPEX", 2007, f. 111, 159, 175, 199; T. J. Poreçki, *Istina o Makedoniji kroz dokumentaciju*, Beograd: 1922, f. 97; Reshat Nexhipi, *Shtypja dhe rezistenca shqiptare në Maqedoni nëpër shekuj*, Manastir: 1996, f. 321; etj.

⁸ *Po aty*; shih edhe *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. IV, Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë, Tiranë: "Toena", 2009, f. 129-149; Lefter Nasi, *Ripushtimi i Kosovës (shtator 1944-korrik 1945)*, Tiranë: Shtypshkronja "Tirana", 1994; Muhamet Shatri, *Kosova në Luftën e Dytë Botërore*, Prishtinë: 1997; Muhamet Pirraku, *Ripushtimi i Kosovës 1945*, Prishtinë: "Dielli", 1992; etj.

⁹ *Historia e Popullit Shqiptar...*, vëll. IV, f. 129-148; *Shqiptarët e Maqedonisë ...*, f. 399; etj.

mundësi PK Jugosllave me në krye J.B.Titon të merrte kontrollin e lëvizjes komuniste dhe të rezistencës antifashiste në gjithë territorin e ish Mbretërisë Jugosllave, duke shmangur në viset jugore ndikimin e PK Bullgare, duke likuiduar nga pozitave drejtuese ata që prireshin drejt saj dhe duke tërhequr në rolin e çirakut, PK Shqiptare dhe forcat antifashiste të armatosura nën kontrollin e saj, edhe përtej kufirit të vitit 1913. Madje për këtë arsye viset shqiptare e përgjithësisht trevat në krahun e djathtë të lumit Vardar, u bënë vatra kryesore antifashiste e rezistencës¹⁰.

II. Trajtimi i çështjes shqiptare në Jugosllavi pas Luftës II Botërore

Paslufta, periudha 1945-1990, i siguroi sllavëve të ish Banovinës së Vardarit për herë të parë një njësi shtetërore të vetën, përkatësisht Republikën e *Maqedonisë*, në kuadër të RSF Jugosllave. Popullsia e quajtur dikur bullgare e gradualisht maqedone, falë dhe një lëvizjeje kryesisht në emigracion që e kish iniciuar idenë prej kohësh, ndoshta qysh më 1903, u njoh komb shtetformues dhe mori drejtimin e administratës, ekonomisë, arsimit dhe çdo sektori tjetër të jetës¹¹. Komunistët maqedonë, të dyzuar midis dy klaneve kryesore të Jugosllavisë, mbajtën qëndrim shovinist ndaj shqiptarëve. Në Republikën e Maqedonisë këta, ndonëse përbënin rreth 1/3 e banorëve, mbetën një popullsi e dorës së dytë, e paragjykuar, injoruar e keqtrajtuar, edhe pse fillimisht, deri në vitin 1948, raportet shtetërore të Jugosllavisë me Shqipërinë, ishin të tilla që situatën në fjalë e bëjnë të duket paradoksale. Madje popullsia shqiptare, në Maqedoni, sikurse në Malin e Zi dhe në komunat shqiptare në jug të Serbisë, u vu në një pozitë edhe më të vështirë se në Kosovë¹².

Për elitën e lartë politike të Jugosllavisë, nuk bëhej fjalë për t'i bashkuar viset shqiptare në një njësi të vetme shtetërore. Mareshali Tito

¹⁰ *Po aty*; shih edhe L. Nasi, *vep. e përm.*, f. 151; Masar Kodra, *Shqiptarët e Maqedonisë gjatë Luftës së Dytë Botërore (1939-1944)*, Kumanovë: Македонска ризница, 1996, f. 52, 115, 169, 177 etj.

¹¹ *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll.IV, *vep. e përm.*, f. 339-371; shih edhe *Shqiptarët e Maqedonisë ...*, f. 451, 479, 509, 601; Marenglen Verli, *Shqipëria dhe Kosova – historia e një aspirate*, vëll. II, Tiranë: “BOTIMPEX”, 2008, f. 15, 40, 43, 61; M.Verli, *Kosova sfida shqiptare...*, f. 388; Zeqirja Idrizi, *Pozita e shqiptarëve në Maqedoni pas Luftës së Dytë Botërore*, Tiranë: “Luma”, 2003, f. 15, 51, 71, 138; etj.

¹² *Po aty*.

dhe pasuesit e tij, ndërsa synonin ekspansion në Ballkan dhe krijimin e një shteti të madh, një konfederate në gadishull, ku do të përfshihej edhe Bullgaria, e së paku si republika e shtatë e Jugosllavisë edhe Shqipëria, bënë politikën e balancimit të orekseve shoviniste të elitave komuniste të kombeve kryesorë sllavë për të ruajtur ekuilibrin e Federatës. Në këtë kuadër, veçanërisht deri në Plenumin e Brionëve të vitit 1966, dhe pas vitit 1981, republikat jugore të Federatës, *Serbia, Maqedonia dhe Mali i Zi*, u toleruan të dhunonin maksimalisht elementin shqiptar¹³. Pasojat ishin drastike: rreth 400 mijë të shpërngulur vetëm deri në vitin 1968, braktisja ose profilizimi i papërshtatshëm ekonomik i viseve shqiptare dhe rënia relative e konsiderueshme e të ardhurave për banor të paktën 2-3 herë për popullsinë shqiptare, krahasuar me mesataren federative, pastaj neglizhimi i zhvillimit të arsimit e kulturës shqiptare etj¹⁴.

Për këtë situatë të rëndë natyrisht kishte ndikuar edhe politika e Republikave Veriore të Jugosllavisë. Deri në vitin 1991, *Kroacia dhe Sllovenia* kalkuluan sipas interesave të tyre të ngushta çdo lëvizje e pozicionim ndaj çështjes së shqiptarëve në RSFJ. Qëndrimet e tyre në fakt ishin rezultante e raporteve të klaneve serbo-malazeze dhe kroato-slllovene nëpër dekada dhe synimi për rol parësor në Federatë. Gjithsesi interesimi i pamjaftueshëm i elitave politike të Republikave Veriore gjatë viteve 80-të për çështjen shqiptare, kur në skenën politike jugosllave nuk kishte më figura të formatit të Eduard Kardelit (vdekur më 1979) dhe Josif Broz Titos (vdekur më 1980), të afta për të ruajtur ekuilibrin, dëshmon se atyre problemi u dukej i largët dhe irracional. Vetëm nga fundi i viteve 80-të, në Zagreb e Lubjanë filloi të kuptohej se ishte fjala për vetë ekzistencën e Federatës, por ishte tejet vonë sepse ndërkohë lufta ishte në prag. Pas kësaj, rivlerësimi i shqiptarëve dhe çështjes së tyre do të diktohej nga situata e re dhe konflikti etnik që shkërmoqi Jugosllavinë¹⁵.

Në periudhën 1945-1948 *Shqipëria* e ndodhur nën tutelën jugosllave, edhe pse ishte e informuar për gjendjen e shqiptarëve matanë

¹³ *Po aty*.

¹⁴ Z. Idrizi, *vep. e përm.*, f. 51, 96, 111, 138; *Shqiptarët e Maqedonisë...*, f. 451, 479, 499, 509, 577, 601; etj.

¹⁵ Bernard Lory, *Europa Ballkanike nga 1945 në ditët tona*, Tiranë: "Dituria", 2007; Stipe Mesiç, *Si është shkatërruar Jugosllavia*, Tiranë: "55", 2007; Mark Mazower, *Ballkani, Një histori e shkurtër*, Tiranë: Skanderbeg Books, 2010, f. 151, f. 249.

kufirit, nuk mund ta ngrinte çështjen e shqiptarëve në Jugosllavi. Shumë flitet për ndonjë bisedë konfidenciale të Enverit me Titon ku zihej në gojë vetëm Kosova, madje vetëm në aspektin e përkatësisë territoriale, por jo edhe për politikën e trajtimit të popullsisë¹⁶.

Gjithsesi edhe periudha pas vitit 1948 e la përgjithësisht jashtë loje Tiranën zyrtare, për të vepruar me efektivitet në mbrojtje të bashkëkombësve matanë kufirit. Shqipëria vetë, në fakt nuk kish në asnjë aspekt potencialin, jo për zgjidhjen, por as për ngritjen në forume ndërkombëtare të çështjes së trajtimit të shqiptarëve në Jugosllavi. Ndërsa miqtë e saj të “mëdhenj”, të viteve 1948-1978, apo aleatët strategjikë, BRSS fillimisht dhe më pas R.P. e Kinës, kishin arsye të mos preknin interesat e RSF Jugosllavisë, herë për politikë rajonale, e bilanc të forcave midis dy blloqeve, herë për sentimente pansllaviste, herë për strategji të përkrahjes së “bllokut të të paangazhuarve”, apo “botës së tretë”, ku e kish rreshtuar Jugosllavinë Mareshali Tito, herë për alergji për të trajtuar, pale më për të ndërhyrë në të mirë të zgjidhjes së problemeve të minoriteteve (edhe pse shqiptarët në fakt s’ishin minoritet në Jugosllavi, e po kështu edhe brenda Republikës së Maqedonisë) etj¹⁷.

Pas vitit 1978, Shqipëria u izolua si asnjëherë më parë dhe, e mbetur në vështirësi deri për ekzistencë, si edhe e varur në përmasa të paimagjinueshme nga tregtia me kliring me Jugosllavinë për mallrat më të domosdoshme, natyrisht nuk mund të bënte më tepër se një luftë verbale me Jugosllavinë për çështjen e bashkëkombësve të vet atje, të destinuar vetëm për veshët e popullsisë në Shqipëri, por jo edhe për përplasje e luftë reale në forumet ndërkombëtare¹⁸.

III. Trajtimi i çështjes shqiptare nga shtetet e Ballkanit dhe faktori ndërkombëtar

Greqia, e cila për një gjysëm shekulli ishte luhatur midis moskokëçarjes, ose vëmendjes së pakët për fqinjin verior, të kushtëzuar nga shumë probleme të tjera, dhe simpatisë për Serbinë e ortodoksizmin,

¹⁶ Enver Hoxha, *Titistët*, Tiranë: “8 Nëntori”, 1981.

¹⁷ N. Malcolm, *vep. e përm.*, f. 327, 332-334; M. Verli, *Kosova sfida shqiptare ...*, f. 380; *E vërteta mbi Kosovën dhe shqiptarët në Jugosllavi*, Tiranë: “8 Nëntori”, 1990, f. 559-635; etj.

¹⁸ *Po aty*; shih edhe *Shtypi botëror rreth ngjarjeve në Kosovë*, Tiranë: “8 Nëntori”, 1981; *Ç’thonë dhe ç’mendojnë kosovarët*, Tiranë: “8 Nëntori”, 1982; *Gazeta Zëri i Popullit*, Tiranë: 1980-1991.

pas Luftës së Dytë Botërore, pati përballë një Jugosllavi Socialiste Federative armike, të paktën deri në vitin 1949. Vetëm trysnia sovjetike do të ndryshonte raportet, që u riformatuan pozitivisht në Bled, në gushtin e vitit 1954, me arritjen e Paktit Ballkanik midis Jugosllavisë, Greqisë dhe Turqisë, edhe pse kjo strukturë politike delikate do të asgjësohej shpejt, pas një viti nga çështja qipriote, që armiqësoi Greqinë me Turqinë, dhe nga riafrimi i Beogradit me Moskën. Në vijim, edhe pse raportet e Beogradit me Athinën nuk ishin të këqia, republika jugosllave më jugore me emrin Maqedoni mbeti për Greqinë “halë në sy”. Ky emër do të bëhej “mollë sherri” e gangrene, veçanërisht pas vitit 1990, në marrëdhëniet bilaterale greko-maqedone duke mbetur kështu deri në ditët tona. Gjithsesi, Greqia asnjëherë si mori në konsideratë pozitivisht shqiptarët e Maqedonisë, çështjen e tyre, madje edhe vetëm problemin e të drejtave njerëzore të tyre. Nuk mund të ndodhte ndryshe përderisa elita politike e Greqisë së pasluftës së Dytë Botërore, bartëse e ideve ekstreme nacionale e fetare të njohura ndaj kombit shqiptar, ndodhej në kampin e kundërt politik me Shqipërinë komuniste të E. Hoxhës, madje kishte konservuar “gjendjen absurde të luftës” me të, për të zhdukur përgjithnjë “çështjen çame” dhe për të ëndërruar më tej për Shqipërinë e Jugut, dhe për aleancën me vëllezërit ortodoksë serbë (përkohësisht komunistë)¹⁹.

Raportet shqiptaro-rumune shquhen për një “prehistori” pozitive. Diaspora e hershme shqiptare në viset që u përfshinë në shtetin e pavarur të Rumanisë, kishte kontribute të shquara në jetën politike, ekonomike, kulturore etj. Rumania gjatë shek. XIX u bë streha e një kolonie të fuqishme shqiptarësh me kontribut të shquar në Rilindjen Kombëtare Shqiptare. Më pas Bukureshti zyrtar mbështeti krijimin, njohjen dhe konsolidimin e Shqipërisë së pavarur dhe, pas vitit 1920, u kujdes pranë regjimit të Tiranës, për mirëtrajtimin e pakicës vllahe në Shqipëri²⁰. Raportet midis dy shteteve ishin normale gjatë gjithë periudhës midis dy luftrave botërore, por për çështjen e shqiptarëve autoktonë në Jugosllavi e Greqi, Rumania nuk rezultoi të jetë prononcuar.

Rumania e Pasluftës Botërore, i ruajti marrëdhëniet normale me Republikën e Shqipërisë, aq më tepër se bënin pjesë të dyja në “Kampin

¹⁹ *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll.IV, f. 258, 407-417; shih edhe Beqir Meta, *Tensioni greko-shqiptar 1939-1949*, Tiranë: “GEER”, 2002; Beqir Meta, *Shqipëria dhe Greqia 1949-1990*, Tiranë: “Globus R”, 2007; Beqir Meta, *Tragjedia çame*, Tiranë: “KLEAN”, 2010; B. Lory, *vep. e përm.*, f. 63, 194; etj.

²⁰ *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. III, f. 58, 272.

socialist”. Por Republika e Rumanisë, e ndjeshme ndaj problemit të minoriteteve, që dëshironte ta konsideronte temë tabu, ishte dhunuese e minoriteteve serbe e gjermane të Banatit rumun, ndaj, ndonëse aktive në fushatën për denigrimin e Jugosllavisë pas vitit 1948, për shkak të servilizmit ndaj BRSS, çështjen e shqiptarëve në Jugosllavi nuk mund ta prekte, aq më tepër se një gjë e tillë nuk dëshirohej as nga Moskë. Më pas në vitet 60-të qëndrimi i saj ndaj RSFJ, e veçanërisht Serbisë së pas viteve 90-të, herë për shkak të frikës nga politika agresive e Moskës e herë për shkak të alergjisë ndaj Hungarisë, me të cilën kishte probleme të vjetra, të dala në sipërfaqe më 1985, u bë miqësor. Rumania mbajti raporte miqësore edhe me Tiranën zyrtare, veçanërisht në vitet 60-80-të, dhe vijoi ta mirëtrajtojë diasporën shqiptare në Rumani, por, për çështjen shqiptare në ish Jugosllavi, ajo edhe sot e kësaj dite është jo në krahun e shqiptarëve. Duket se afrimi i Bukureshtit zyrtar me Shqipërinë pas vitit 60-të, pjesë e ripozicionimeve në kampin komunist, u bë natyrisht në lidhjen e atyre që kundërshtonin Moskën brenda “kampit socialist”, (Rumania konfliktonte për probleme ekonomike, por nuk harronte edhe humbjen e Besarabisë dhe Bukovinës), por ndoshta edhe me konsensusin e heshtur për mosprekjen kurrë të çështjes së “pakicave”²¹.

Interesant ishte edhe pozicioni i *Bullgarisë* ndaj çështjes shqiptare. Prehistoria e marrëdhënieve shqiptaro-bullgare në hulinë e traditës historike, me piketa të dukshme gjatë periudhës së Rilindjes Kombëtare Shqiptare, përgjithësisht kishte qenë pozitive. Pas krijimit të shtetit shqiptar, Bullgaria, e armiqësuar me Serbinë e Greqinë qysh në vitin 1913, kur u përlesh me të gjithë fqinjët në kuadër të Luftës së Dytë Ballkanike, planifikoi një aleancë serbo-bullgare-shqiptare dhe gjithashtu e përdori territorin e Shqipërisë për çetat e komitëve bullgaro-maqedonë. Bashkëpunimi i tyre me irredentistët kosovarë dhe eventualisht me opozitën në Shqipëri, ose kërkesa e pamiruar nga Tirana zyrtare për të njohur popullsinë e Gollobordës si minoritet, gjithsesi nuk çuan në ndonjë keqësim të dukshëm të raporteve midis dy vendeve²². Por qëndrimi i armatës bullgare ndaj shqiptarëve në viset e okupuara, qoftë në vitet 1916-1918, qoftë në vitet 1941-1944, meritonte shumë kritika²³.

²¹ *Po aty*, f. 240, 254; S. Mesiq, *vep. e përm.*; B. Lory, *vep. e përm.*, f. 151, 194.

²² *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. III, f. 48, 55, 428.

²³ *Po aty*, f. 435, 438.

Pas Luftës së Dytë Botërore, përfshirja e të dy shteteve në “Kampin Socialist” i forcoi marrëdhëniet bilaterale, që pas vitit 1948 do të ishin edhe më të ngrohta. Për kuriozitet do të përmendim se një shtetas shqiptar, Agllai Zoto, e martuar me një shtetas bullgar, do të arrinte deri në detyrën e zv.ministres në dikasterin e Drejtësisë në Sofje²⁴. Por përgjithësisht Sofja zyrtare, ndjekëse besnike e politikës së Moskës, gjatë gjithë periudhës së pasluftës deri në vitin 1990, nuk do të prononcohej për çështjen e shqiptarëve në Jugosllavi²⁵. E interesuar në dy dekadat e fundit, veçanërisht për situatën në Maqedoni, ajo i ka marrë në konsideratë shqiptarët e kësaj republike si një faktor i paanashkalueshëm. Po për këtë arsye, ajo ka vëzhguar me vëmendje edhe zhvillimet në Kosovë dhe bën pjesë ndër shtetet e “grupit të dytë” që e kanë njohur Republikën e Kosovës më 20 mars 2008, rreth një muaj pas shpalljes së saj që ndodhi më 17 shkurt 2008, edhe pse ekziston opinioni se kjo lidhet me përfshirjen e saj në BE (1 janar 2007) dhe NATO (29 mars 2004) dhe me ekzistencën e raporteve jo të mira nga e kaluara midis Sofjes dhe Beogradit.

Qëndrimi i faktorit ndërkombëtar apo demokracive perëndimore, në periudhën në fjalë u përcaktua nga gjeostrategjia e tyre dhe lufta e blloqeve, që e vlerësonin Shqipërinë bastion të stalinizmit dhe shqiptarët në Jugosllavi element me potencial destabilizues për Federatën, që duhej ruajtur për të minuar “kampin socialist”. Ndoshta brezi i pasluftës botërore i diplomatëve perëndimorë e shikonte çështjen nga këndvështrimi tradicional, i ngulitur veçanërisht gjatë “Luftës së Ftohtë” dhe nuk kishte as qartësi gjeopolitike, as njohjen e nevojshme për çështjen shqiptare, për ta vlerësuar atë me realizëm, rrjedhimisht edhe gjithë situatën në rajon²⁶.

Pikërisht për sa thamë më sipër, kur Lindja komuniste u gjuhëzua përballë Perëndimit demokrat, dhe Federata Jugosllave, e mbajtur në këmbë përmes kredive me shumicë, të siguruara edhe me mjeshtërinë e një ekuilibristi si mareshali Tito, u shpërbë, qëndrimi i faktorit ndërkombëtar ndaj shqiptarëve filloi të ndryshonte, përfshi edhe

²⁴ TV-Klan, Emisioni “Histori me zhurmues”, 18.12.2010, Intervistë e gazetarit Pandi Laço me zonjën Agllai Zotaj.

²⁵ *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. IV, f. 147, 239.

²⁶ N. Malcolm, *vep. e përm.*, f. 368-369; M. Mazower, *vep. e përm.*, f. 128-153; Janusz Bugajski, *Ngritja e Kosovës*, Prishtinë: “KOHA”, 2006, f. 11-13; M. Verli, *Shqipëria dhe Kosova ...*, f. 61, 281, 302-321; etj.

qëndrimin ndaj shqiptarëve në Republikën e Maqedonisë²⁷. Rivlerësimi i faktorit shqiptar dhe hapat në të mirë të zgjidhjes së çështjes kombëtare shqiptare janë varur e do të varen natyrisht edhe nga pesha, përkatësisht niveli, apo standardet, me të cilat ai është prezantuar e do të prezantohet para botës së sotme demokratike, predispozitat e së cilës globalisht, pa hyrë këtu në diferencimet e natyrshme, janë pozitive në mënyrë të padiskutueshme. Sot Fuqitë Euroatlantike i mbajnë në vëmendje problemet shqiptare, sepse shqiptarët kanë një vend të rëndësishëm në ndërthurjen e politikave gjeostrategjike në Ballkan. Faktori vendimmarrës ndërkombëtar e vuri në rrugën e zgjidhjes çështjen e Kosovës dhe është treguar shumë i interesuar për çështjen e trajtimit të shqiptarëve në Maqedoni, Serbi e Malin e Zi²⁸.

Pa u ndalur në diferencat, zhvendosja e dukshme e Fuqive Perëndimore nga qëndrimet e vjetra gjatë dy dekadave të fundit për problemet shqiptare përgjithësisht, si edhe impenjimi i tyre serioz për stabilitet në Shqipëri në vitet 90-të, në Kosovë në vitin 1999 edhe me armë, dhe në Maqedoni më 2001 etj., përbëjnë një shans të madh për shqiptarët kudo që ndodhen, por edhe për sigurinë e stabilitetin në rajon. Përveç Rusisë që mbetet ende aleat i forcave konservatore e shoviniste sllave dhe, me sa duket, është e interesuar për një Ballkan të destabilizuar, të gjithë të mëdhenjtë perëndimorë, në një masë ose në një tjetër, janë të pozicionuar ndryshe. Ata objektivisht përkrahin zgjidhje të cilat kanë të ardhme pozitive për kombin shqiptar, kudo ku ndodhet²⁹. Problemet e mëdha globale, të shtruar për zgjidhje, ka shenja se po ndërgjegjësojnë edhe ata që s'kanë qenë ndonjëherë përkrah shqiptarëve, se duhen kapërcyer kontradiktat dhe se bashkëpunimi pragmatist, por edhe transformimi masiv psikologjik, janë elemente, të cilat po e ridimensionojnë pozitivisht edhe

²⁷ *Po aty*; shih edhe Jens Reuter & Konrad Clewing, *Der Kosovo konflikt, Ursochen Verlaut, perspektiven*, München: "Wieser Verlag", 2000, f. 171, 187, 227, 247, 305, 321; etj.

²⁸ *Po aty*; shih edhe Esat Stavileci, *Kosova nën administrimin ndërkombëtar*, Gjakovë: Shtypshkronja "PROGRAF", 2000, f. 28; Edita Tahiri, *Konferenca e Rambujesë* (Procesi negociator dhe dokumentet), Pejë: "Dukagjini", 2001, f. 10, 13, 22; Sylë Ukshini, *Kosova dhe Perëndimi*, Prishtinë: "KOHA", 2001, f. 87, 109, 113, 247; etj.

²⁹ J. Reuter & K. Clewing, *Der Kosovo konflikt ...*, f. 187, 213, 227, 321, 335, 381, 395, 417, 429, etj.; shih edhe Shaqir Vukaj, *Rusia dhe Kosova* (shënimet e një diplomati), Tiranë: Shtypshkronja "Eriko Kuço", 2007, f. 23, 28, 132, 159, 542, 547; etj.

faktorin shqiptar, duke shpejtuar zgjidhjen bashkëkohore të çështjes shqiptare³⁰.

Gjithsesi shqiptarëve u duhet të ndreqin me ngut të metat e tyre, të dëshmojnë qytetërim, unitet, aftësi qeverisëse, vlera të demokracisë etj. Shkurt, të shfaqen si një faktor me peshën maksimale në peshoren e gjeopolitikëve ballkanike. Është koha për të nxituar në rrugën e duhur që të siguron vendin e kërkuar dhe partneritet të denjë.

S u m m a r y

ON THE TREATMENT OF THE ALBANIAN ISSUE IN YUGOSLAVIA ON A BALKAN LEVEL (AFTER 1945)

The issue of the Albanians in Yugoslavia, undoubtedly part of the Albanian issue in its entirety, started with the drastic disintegration of the Albanian territories.

By institutionalizing and intensifying the policy of ethnic cleansing in the annexed Albanian regions, Yugoslavia legitimated, between the two Wars, the struggles of the native Albanian population towards the obtainment by all means of their human and national rights.

After World War II, the Yugoslavian political elite followed the policy of balance between the republics, in order to maintain the equilibrium of the Federation. In that scope, especially until the Brioni Plenum of 1966, and after 1981, the southern republics of the Federation, *Serbia, Macedonia and Montenegro*, were tolerated to maximally aggress the Albanian element. On the other hand, the position of the northern republics of *Slovenia* and *Croatia* would be resultant of the relations between the Serbian – Montenegrin and Croatian -Slovenian alignments. However, for a long time, their interest on the Albanian issue was insufficient. It wasn't until the end of the '80s, when the dissolution of Yugoslavia started making surface, that the Albanian factor would be reevaluated and the issue would be considered seriously.

During 1945 – 1948 Albania, which was under the Yugoslavian tutelage, despite being aware of the condition of the Albanians across the border, could not raise the issue of the Albanians in Yugoslavia. However, even the phase that followed 1948 left the official Tirana generally out of the game of an effective action that would defend the compatriots across the border.

The rest of the Balkan countries, *Greece, Bulgaria* and *Rumania*, regardless of the tradition and the historical links, or the various relations with the Albanian Republic, neglected or remained silent for many years regarding the issue of the Albanians in Yugoslavia.

³⁰ Po aty.

The position kept by the Great Powers, or the western democracies was determined, during this period, by their regional geostrategic interests, which, during the last two decades generally favored the Albanians.